



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË ARRËZ

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. ____ prot.

Fushë Arrëz, më ____ .2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ datë ____ / ____ /2024

**PËR NGRITJEN E BORDEVE TË KOPSHTEVE DHE MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR NGRITJEN DHE FUQIZIMIN E BORDIT TË KOPSHTIT”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 54 pika n, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 28, pika 4, shkronjat “a”, “b” dhe “d”, nenit 34 të Ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimit nr. 25, date 25.07.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”, Këshilli Bashkiak Fushë Arrëz:

V E N D O S I

1. Në bashkëpunim me ZVAP, themelimin e Bordit të Kopshtit dhe funksionimin e plotë të tij në çdo kopësht nën juridiksionin e Bashkisë Fushë Arrëz.
2. Miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Bordit të kopshtit”.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.

KRYETARI I KËSHILLIT

Nikolin BARDHOKU



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË ARRËZ**

Drejtoria Arsimit

Nr. _____ prot.

Fushë Arrëz, më _____.2024

RELACION

**PËR NGRITJEN E BORDEVE TË KOPSHTEVE DHE MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT TË KOPSHTIT”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 54 pika n, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 28, pika 4, shkronjat “a”, “b” dhe “d”, nenit 34 të Ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimit nr. 25, date 25.07.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”, Bashkia në bashkëpunim me ZVAP duhet të themelojë e Bordin e Kopshtit në çdo kopësht nën juridiksionin e Bashkisë Fushë Arrëz. Për një funksionim sa më të mirë bordeve paraqesim për miratimin e Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Bordit të kopshtit”.

Përgjegjësi i Arsimit

Altin Engjëlli